



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI
DREJTORIA E ÇËSHTJEVE PROÇEDURALE LIGJORE DHE MARRËDHENIEVE ME JASHTË

Nr. 204/ Prot.

Tiranë, më 07 / 05 / 2013

Lënda : Dërgohen komentet lidhur me kërkesën Tuaj me Nr. 12 Akti, datë 16.04.2013.

Drejtuar : **GJYKATËS KUSHTETUESE**

TIRANË

Në përgjigje të shkresës Tuaj me nr. 12 Akti të datës 16.04.2013, me anë të së cilës kërkohen komente lidhur me kërkesat e paraqitura nga Këshilli Kombëtar i Personave me Aftësi të Kufizuara dhe Shoqata e të Verbërve të Shqipërisë, me objekt: “*Deklarimi si të papajtueshëm me Kushtetutën, Konventën e Organizatës së Kombeve të Bashkuara për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara, Konventën Europiane të të Drejtave të Njeriut dhe Kartën Sociale Europiane, i pikave 7 dhe 9 të nenit 3 të ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010 ‘Për mbrojtjen nga diskriminimi’*”, Komisioneri për Mbrotjen nga Diskriminimi parashtron sa më poshtë vijon qëndrimin e tij lidhur me kërkesat e paraqitura :

Së pari, do të donim të nënvironim faktin se në kërkesën e paraqitur kundërshtohen si diskriminuese dhe të papajtueshme me Kushtetutën dy pika të nenit 3 të ligjit nr. 10 221, date 04.02.2010, të titulluar “Përkufizimet”. Sipas manualeve të teknikës legjislative pjesa e përkufizimeve në tekstet normative jep për secilin nacion të listuar në të, kuptimin se si duhet marrë apo kuptuar ai çdo herë që përdoret në dispozitat e ligjit në analizë. Pikërisht edhe neni 3, ka si qëllim të japë kuptimin se si duhen kuptuar shprehjet e dhëna për qëllim



Adresa: Rruga Sami Frashri, Nr. 10, Kat II, Tiranë
(Tek godina e Fondit Shqiptar të Zhvillimit)
Tel: +355 4 2431078
Fax: +355 4 2431077
e-mail: info@kmd.al
web: www.kmd.al

të interpretimit të dispozitave të ligjit nr. 10 221 datë 04.02.2010. Duke patur qëllim deklarativ, pikat 7 dhe 9 të nenit 3 të ligjit, nuk u imponojnë subjekteve detyrimin për sjellje të caktuar, por orientojnë për kuptimin që kanë togfjalëshat “Mohim i një përshtatje të arsyeshme” dhe “Organizata me interesa legitime” në dispozitat vijuese.

➤ Në lidhje me themelin e pretendimeve :

Neni 18 i Kushetutës sanksionon se: “*1. Të gjithë janë të barabartë përpara ligjit. 2. Askush nuk mund të diskriminohet padrejtësisht për shkaqe të tilla si gjinia, raca, feja, etnia, gjuha, bindjet politike, fetare ose filozofike, gjendja ekonomike, arsimore, sociale ose përkatësia prindërore. 3. Askush nuk mund të diskriminohet për shkaqet e përmendura në paragrafin 2, nëse nuk ekziston një përligjje e arsyeshme dhe objektive.*”. Në bazë të këtij neni, Kushtetuta parashikon se trajtimi ndryshe apo diskriminimi përligjet nëse ekzistojnë shkaqe objektive dhe të arsyeshme. Në mbështetje të nenit 18 të Kushetutës, Kuvendi i Shqipërisë, ka miratuar ligjin nr. 10221 datë 04.02.2010 “Për mbrojtjen nga diskriminimi”¹, i cili ka si objekt të tij rregullimin e zbatimit dhe respektimit të parimit të barazisë në lidhje me një sërë shkaqesh, ndër të tjera edhe në lidhje me aftësinë e kufizuar.

Ligji nr. 10221 datë 04.02.2010 “Për mbrojtjen nga diskriminimi”, është gjithashtu një ligji i cili është miratuar në kuadër të procesit të integrimit të vendit në Bashkimin European dhe në përbushje të detyrimeve që burojnë nga Marrëveshja e Stabilizim Asociimit, për të përafruar legjislacionin e brendshëm me *acquis communautaire*. Ky ligj është përafruar plotësisht me direktivat e Bashkimit European në fushën e trajtimit të barabartë dhe konkretisht: Direktivën e Këshillit 2000/43/KE të 29 qershorit 2000 për “Zbatimin e parimit të trajtimit të barabartë ndërmjet personave pavarësisht prejardhjes racore apo etnike”; Direktivën e Këshillit 2000/78/KE të 27 nëntorit 2000 për “Përcaktimin e një kuadri të përgjithshëm për trajtimin e barabartë në punësim dhe marrëdhëniet gjatë punës”; Direktivën e Këshillit 2004/113/KE të 13 dhjetorit 2004 për “Zbatimin e parimit të trajtimit të barabartë ndërmjet burrave dhe grave në mundësinë për të pasur dhe për t'u furnizuar me mallra dhe shërbime” dhe Direktivën e Parlamentit European dhe të Këshillit 2006/54/KE të 5 korrikut 2006 për “Zbatimin e parimit të mundësive të barabarta dhe të

¹ Ligji nr. 10221 datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi” është botuar në Fletoren Zyrtare nr. 15 datë 25 shkurt 2010.



Adresa: Rruga Sami Frashri, Nr. 10, Kat II, Tiranë
(Tek godina e Fondit Shqiptar të Zhvillimit)
Tel: +355 4 2431078
Fax: +355 4 2431077
e-mail: info@kmd.al
web: www.kmd.al

trajtimit të barabartë të burrave dhe grave në çështjet e punësimit dhe marrëdhëniet gjatë punës”.

Trajtimi i barabartë lidhur me aftësinë e kufizuar trajtohet nga Direktiva e Këshillit 2000/78/KE të 27 nëntorit 2000 për “*Përcaktimin e një kuadri të përgjithshëm për trajtimin e barabartë në punësim dhe marrëdhëniet gjatë punës*”, dhe vetëm në kuadër të marrëdhënieve të punës.

Në nenin 6 “*Trajtimi i ndryshëm i përligjur*”, të ligjit sanksionohet se : **“1. Ndalimi i diskriminimit i përshkruar nga ky ligj nuk zbatohet në raste kur ka një qëllim objektivish të justifikueshëm dhe të përligjur në bazë të Kushtetutës, të marrëveshjeve apo akteve ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë dhe legjislacioni në fuqi. 2. Trajtimi i ndryshëm që bazohet në një karakteristikë të lidhur me shkaqet e përmendura në nenin 1 të këtij ligji, nuk përbën diskriminim kur për shkak të natyrës së aktiviteteve profesionale, ose të kushteve në të cilat profesiioni ose veprimtaria ushtrohet, këto karakteristika përbëjnë një kërkesë të vërtetë dhe profesionale të domosdoshme, me kusht që qëllimi i trajtimit të ndryshëm të jetë i përligjur dhe kërkesa të mos kapërcejë atë qfarë është e domosdoshme për realizimin e saj.”**

Ne vlerësojmë se interpretimi dhe kuptimi i parashikimeve që bëhen në Ligjin nr. 10221 datë 04.02 2010 “*Për mbrojtjen nga diskriminimi*”, duhet të bëhet edhe duke mbajtur parasysh legjislacionin e Bashkimit Europian me të cilin ky ligj është përafruar.

Direktiva 2000/78, në pikën 17 të preambulës së saj shprehet se : “*Kjo Direktivë nuk kërkon rekrutimin, promovimin, mbajtjen në punë apo aftësimin e një individi i cili nuk është kompetent, i aftë dhe i disponueshëm, për të kryer funksionet thelbësore të postit në fjalë ose t'i nënshtronen trajnimit përkatës, pa paragjykimim ndaj detyrimit për të siguruar përshtatje të arsyeshme për personat me aftësi të kufizuara*”.

Së fundmi, me ligjin nr. 108/2012, Kuvendi ka ratifikuar Konventën e Organizatës së Kombeve të Bashkuara “*Për të drejtat e personave me aftësi të kufizuara*”. Kjo Konventë e cila tashmë është pjesë e rendit të brendshëm juridik, përfaqëson dhe standartin më të lartë të mbrojtjes së të drejtave të personave me aftësi të kufizuara.

Konventa nuk përfshin një përkufizim të aftësisë së kufizuar ose personave me aftësi të kufizuara, por jep më tepër disa udhëzime për konceptin e aftësisë së kufizuar. Në nenin 1 të



Adresa: Rruga Sami Frashri, Nr. 10, Kati II, Tiranë
(Tek godina e Fondit Shqiptar të Zhvillimit)
Tel: +355 4 2431078
Fax: +355 4 2431077
e-mail: info@kmd.al
web: www.kmd.al

saj shprehet se : “*Personat me aftësi të kufizuara përfshijnë ata që kanë dëmtimë fizike, mendore, intelektuale apo shqisore afatgjata, të cilat, në ndërveprim me bariera të ndryshme, mund të pengojnë pjesëmarrjen e tyre të plotë dhe efektive në shoqëri në baza të barabarta me të tjerët.*”

Ndërsa në gjermën “e”, të preambulës së saj, Konventa thekson se: **aftësia e kufizuar** është një koncept evolues dhe se aftësia e kufizuar rezulton nga ndërveprimi ndërmjet personave me dëmtimë dhe barrierave të qëndrimit/mentalitetit dhe ambientit, që pengojnë pjesëmarrjen e tyre të plotë dhe efektive në shoqëri në nivel të barabartë me të tjerët

- Në lidhje me kërkësën për kundërshtimin e pikës 7, të nenit 3 të Ligjit nr. 10 221 datë 04.02.2010 “*Për mbrojtjen nga diskriminimi*”:

Komisioneri është i mendimit se parashikimi që bëhet në pikën 7 të nenit 3 të ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010 “*Për mbrojtjen nga diskriminimi*”, nuk është në kundërshtim me Kushtetutën, Konventën e OKB-së “*Për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara*”, Konventën Europiane të të Drejtave të Njeriut dhe Kartën Sociale Europiane. Ky përfundim bazohet në arsyetimin e mëposhtëm:

Konventa e OKB-së dhe Direktiva e Bashkimit Europian parashikojnë se akomodimi/përshtatja e arsyeshme është një masë, një modifikim apo rregullim që bën të mundur që një individ i kualifikuar, me aftësi të kufizuara të gëzojë shanse të barabarta. Duhet të ofrohet akomodim/përshtatje e arsyeshme, nëse akomodimi/përshtatja nuk vendos një barrë të tepruar apo disproporcionale. Pra, në radhë të parë akomodimi duhet të jetë i arsyeshëm. Për të qënë i arsyeshëm ai duhet të jetë i nevojshëm, i përshtatshëm për një rast të caktuar. Më pas, një akomodim/përshtatje e arsyeshme nuk do të përbëjë diskriminim nëse ato nuk përbëjnë një barrë të tepruar/disproporcionale.

Në nenin 2 “*Përkuvizimet*”, të Konventës së OKB-së “*Për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara*” sankzionohet se : “*Diskriminim me bazë aftësinë e kufizuar*” do të thotë që çdo dallim, përjashtim apo kufizim me bazë aftësinë e kufizuar, që ka si qëllim ose ndikon në dëmtimin apo anulimin e njohjes, gëzimit apo ushtrimit, mbi baza të barabarta me të tjerët, të të gjitha të drejtave dhe lirive themelore të njeriut në fushën politike, ekonomike,



Adresa: Rruga Sami Frashri, Nr. 10, Kati II, Tiranë
(Tek godina e Fondit Shqiptar të Zhvillimit)
Tel: +355 4 2431078
Fax: +355 4 2431077
e-mail: info@kmd.al
web: www.kmd.al

shoqërore, kulturore, civile apo në ndonjë fushë tjeter. Ky përkufizim përfshin të gjitha format e diskriminimit, duke përfshirë dhe mohimin e akomodimit të arsyeshëm. "Akomodim i arsyeshëm" do të thotë modifikim dhe rregullim i nevojshëm dhe i përshtatshëm që nuk krijon një barrë disproporcionale, që është i nevojshëm në raste të veçanta, për t'u siguruar personave me aftësi të kufizuara gjëzimin dhe ushtrimin e të gjitha të drejtave dhe lirive themelore të njeriut me baza të barabarta me të tjerët.

Konventa e OKB-së "Për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara" në nenin 2, të saj kushtëzon faktin se mohimi i akomodimit (përshtatjes) të arsyeshme do të përbëjë diskriminim, nëse mohohet kryerja e modifikimeve dhe rregullimeve, të cilat janë të arsyeshme, pra janë të nevojshme dhe të përshtatshme, dhe nuk krijojnë një barrë disproporcionale. Në të kundërt mohimi për të bërë këto modifikime apo rregullime nuk konsiderohet diskriminim.

Konventa e OKB-së nuk ka dhënë ndonjë përcaktim të saktë se çfarë do të përbëjë barrë të tepruar. Aktualisht nuk ka as ndonjë udhëzim apo komentar mbi atë se si duhet të sigurohet dhe interpretohet përshtatja e arsyeshme në frymën e Konventës.

Direktiva 2000/78, në nenin 5 të saj parashikon se: "Për të garantuar zbatimin e parimit të barazisë në raport me personat me aftësi të kufizuara, duhet të ofrohet "përshtatja e arsyeshme". Kjo nënkuption që cdo punëdhënës do të marrë masat e përshtatshme, aty ku paraqitet e nevojshme, në një rast të caktuar, ku personit me aftësi të kufizuara t'i sigurohet aksesi, të përfshihet, të zhvillohet në punë, të sigurojë trajnim për një person të tillë, përvec rasteve kur këto do të përbënin një barrë të tepruar për punëdhënësin"²

Në pikën 20 të preambulës së Direktivës, parashikohet se :20. "Shembuj të masave që duhet të ndërmerrin për të siguruar përshtatjen e një vendi pune për një aftësi të kufizuar të caktuar, mund të jenë, përshtatja e ambienteve apo pajisjeve, struktura e orarit të punës, shpërndarja e detyrave ose trajnime të ndryshme apo mjeteve për t'u integruar".³

Ashtu si edhe Konventa e OKB-së edhe Direktiva 2000/78 e BE-së nuk ka përcaktim se çfarë do të përbënte një përshtatje të arsyeshme dhe çfarë do të konsiderohet një barrë e tepruar.

² Përkthim jo zyrtar

³ Përkthim jo zyrtar



Adresa: Rruga Sami Frashri, Nr. 10, Kati II, Tiranë

(Tek godina e Fondit Shqiptar të Zhvillimit)

Tel: +355 4 2431078

Fax: +355 4 2431077

e-mail: info@kmd.al

web: www.kmd.al

Gjyakta Europiane e Drejtësisë si autoriteti i vetëm për interpretimin e të Drejtës së BE-së, ka nxjerrë së fundmi një vendim paragjykimor ku ka interpretuar pikërisht dispozitat e Direktivës 2000/78, që lidhen me realizimin e përshtatjeve të arsyeshme për personat me aftësi të kufizuara. Kështu Gjykata në vendimin e datës 11 prill 2013, për dy çështjet e bashkuara C-335/11 dhe C-337/11, në kërkesën për tu shprehur me vendim paragjykimor në bazë të nenit 267 të TFBE, përveç konkuzionit të rëndësishëm që ka nxjerrë duke dhënë orientimin se çfare do të kuptohet me “aftësi e kufizuar”, në referim të Direktivës 2000/78, shprehet qartë se në çdo rast kur gjykohet lidhur me detyrimin për të realizuar përshtatje të arsyeshme për personat me aftësi të kufizuara në fushën e punësimit, duhet që përshtatja të jetë e arsyeshme dhe të mos përbëjë një barrë disproporcionale për punëdhënësin. Në këtë vendim Gjykata shprehet se nuk ka përcakttime se çfarë do të konsiderohej një masë e përshtatshme, pasi parashikimet/orientimet që bëhen në paragrafin 20 të preambulës së Direktivës, nuk janë ezauruese, por afirmon se ato duhen interpretuar në një kuptim të gjerë. Gjithashtu edhe për sa i përket vlerësimeve se çfarë do të konsiderohet “barrë e tepruar”, Direktiva nuk bën përcakttime të sakta, por jep vetëm disa kritere që duhet të vlerësohen. Në vendim Gjykata shprehet se për të vlerësuar nëse kemi të bëjmë me “barrë të tepruar” të punëdhënësit, duhet të merren në vlerësim elementët e përmendur në paragrafin 21 të preambulës së Direktivës, i cili parashikon se: 21. “*Për të përcaktuar nëse kemi të bëjmë me barrë të tepruar, duhet të mbahen parasysh vecanërisht kosto financiare apo të tjera, burimet financiare të firmës apo organizatës dhe mundësinë për të marrë fonde publike apo asistencë të një lloji tjetër*”.⁴ Në arsyetimin e këtij vendimi Gjykata i është referar Konventës së OKB-së, pasi ajo pasi është ratifikuar nga BE-ja si organizatë, është bërë tashmë pjesë e legjislacionit të Bashkimit European.

Në pikën 7 të nenit 3 të ligjit nr. 10 221, daë 04.02.2010, është parashikuar se: “mohimi i një përshtatje të arsyeshme”, është një formë diskriminimi dhe bëhet ky përkufizim: “*Mohim i një përshtatjeje të arsyeshme*” është ajo formë diskriminimi që ndodh kurdoherë kur ka një mohim ose kundërshtim për të kryer ndryshime ose rregullime të domosdoshme e të përshtatshme që nevojiten në një rast të veçantë dhe nuk imponojnë një barrë të tepruar, me qëllim që të sigurohet gjëzimi dhe ushtrimi në baza të barabarta i të drejtave dhe lirive themelore për personat me aftësi të kufizuar, ose të ndodhur në kushtet e tjera të përmendura në nenin 1 të këtij ligji.”

⁴ Përkthim jo zyrtar



Në një krahasim të parashikimeve të akteve ndërkombëtare dhe parashikimit që ka bërë pika 7 e nenit 3, të ligjit nr. 10 221, datë 04.02.2010, shohim se ky i fundit është plotësisht në linjë me standartet ndërkombëtare dhe ato europiane që rregullojnë konceptin e përshtatjes së arsyeshme dhe se çfarë do të përbënte diskriminim në kushtet kur përshtatja e arsyeshme do të mohohej për personat me aftësi të kufizuara.

Gjithashtu termi “Barrë”, nuk ka konotacion fyes dhe nuk i duhet bërë referim gjuhës apo terminologjisë që përdorim në zhargonin e përditshëm, por duhet parë në kontekstin e terminologjisë juridike të rastit, në kuadër të së cilës për shembull edhe termi “diskriminim pozitiv” nuk i referohet “diskriminimit” si nocion negativ.

Është tashmë e konsoliduar jurisprudanca e Gjykatës Europiane të të Drejtave të Njeriut se, çdo dallim në trajtim në mënyrë që të mos jetë diskriminues, duhet të ketë justifikim objektiv dhe të arsyeshëm, pra duhet të ndjekë një qëllim legitim dhe duhet të përdorë instrumente që janë përpjeshësimisht të arsyeshme me qëllimin e ndjekur.

➤ Në lidhje me kërkesën për kundërshtimin e pikës 9, të nenit 3 të Ligjit nr. 10 221 datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”:

Konventa mbi të Drejtat e Personave me Afësi të Kufizuara miraton një model i cili i mëshon njohjes së aftësisë së kufizuar si një çështje të të drejtave të njeriut. Një trajtim i tillë kërkon që personat me aftësi të kufizuara të mos konsiderohen më përfitues të bamirësive ose objekte të vendimeve të të tjera, por bartës të të drejtave.

Qëllimi i kësaj konvente është të promovojë, të mbrojë dhe të sigurojë që të gjithë personat me aftësi të kufizuara të gëzojnë plotësisht dhe në mënyrë të barabartë të gjitha të drejtat dhe liritë themelore të njeriut, si dhe të promovojë respektimin e dinjitetit të tyre të lindur. Mbrojtja dhe promovimi i të drejtave të tyre nuk ka lidhje vetëm me shërbimet e ofruara për aftësinë e kufizuar, por kërkon miratimin e masave për të ndryshuar qëndrimet dhe sjelljet që stigmatizojnë apo marginalizojnë personat me aftësi të kufizuara. Përkrah detyrimit për të shfuqizuar, ndryshuar dhe miratuar politika, programe apo ligje që vijnë në kundërshtim me Konventën, kërkohet dhe një rritje e ndërgjegjësimit të të gjithë shoqërisë lidhur me të kuptuarit e aftësisë së kufizuar dhe të drejtave të personave me aftësi të kufizuara.



Adresa: Rruga Sami Frashri, Nr. 10, Kati II, Tiranë
(Tek godina e Fondit Shqiptar të Zhvillimit)
Tel: +355 4 2431078
Fax: +355 4 2431077
e-mail: info@kmd.al
web: www.kmd.al

Në gërmën “ë” të Preambulës së Konventës, ajo shprehet : “*Duke kuptuar se, individi, duke patur detyrime ndaj individëve të tjerë dhe komunitetit të cilit ai apo ajo i përket, ka përgjegjësinë të bëjë përpjekje për promovimin dhe vëzhgimin e të drejtave të mbrojtura në Paketat Ndërkombëtare mbi të Drejtat e Njeriut.*”

Në nenin 12 “Njohja e barabartë para ligjit” të Konventës sanksionohet: “1. Shtetet palë riafirmojnë se personat me aftësi të kufizuara kanë të drejtën e njohjes kudo si persona para ligjit. 2. Shtetet palë do të pranojnë se personat me aftësi të kufizuara gëzojnë zotësi ligjore në bazë të barabartë me të tjerët në të gjitha aspektet e jetës. 3. Shtetet palë do të marrin masat e duhura për të siguruar mundësimin ndaj personave me aftësi të kufizuara për mbështetjen që ata mund të kërkojnë në ushtrimin e kapacitetit të tyre ligjor. 4. Shtetet palë do të sigurojnë se të gjitha masat që lidhen me ushtrimin e zotësisë ligjore sigurojnë masat mbrojtëse të duhura dhe efektive për të parandaluar abuzimin në përputhje me të drejtën ndërkombëtare për të drejtat e njeriut. Masa të tilla mbrojtëse do të sigurojnë se masat e lidhura me ushtrimin e zotësisë ligjore respektojnë të drejtat, vullnetin dhe preferencat e personit, nuk kanë konflikt interesit dhe ndikim të panevojshëm, janë në proporcionalitetë përshtatura sipas rrethanave të personit, aplikohen për periudhën më të shkurtër të mundshme dhe u nënshtronen rishikimeve të rregullta të një autoriteti kompetent, të pavarur dhe të paanshëm apo një organi gjyqësor. Masat mbrojtëse do të janë proporcionale, në shkallën ku masa të tilla prekin të drejtat dhe interesat e personit.....” . Për sa i përket këtij nenit të Konventës, mendojmë se nuk ka asnjë lidhje me dispozitën e ligjit (neni 3/9), e cila pretendohet se vjen në kundërshtim me këtë nen. Ky nen i Konventës nuk ka të bëj me rregullat e përfaqësimit, por me rregullimin e “zotësisë juridike për të vepruar”.

Në pikën 9 të nenit 3, të ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010, bëhet një përkuzim për termin “organizata me interesa legjitime” me këtë përbajtje: “*Organizatat me interesa legjitimë” janë ato organizata, të cilat janë të regjistruara në Republikën e Shqipërisë dhe kanë si objekt të deklaruar të veprimtarisë së tyre mbrojtjen e të drejtave të njeriut, ose u ofrojnë ndihmë viktimate të diskriminimit.*”

Nëse i referohemi parashikimeve që bëhen në tërësinë e ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010, për të parë kontekstin në të cilin është përdorur termi i përkufizuar në pikën 9 të nenit 3 të ligjit, konstatojmë se ky term përdoret vetëm në dy momente, në nenin 33 të ligjit ku parashikohen procedurat e shqyrtimit të ankesave përpara Komisionerit dhe në nenin 34 në procedurat para gjykatës.



Adresa: Rruga Sami Frashri, Nr. 10, Kati II, Tiranë
(Tek godina e Fondit Shqiptar të Zhvillimit)
Tel: +355 4 2431078
Fax: +355 4 2431077
e-mail: info@kmd.al
web: www.kmd.al

Kështu në nenin 33/1/2 sanksionohet se : “*1. Një person ose grup personash që pretendojnë se janë diskriminuar, ose një organizatë me interesa legjitimë që pretendon diskriminim në emër të një personi apo grapi personash, mund të paraqesë ankesë së bashku me provat e disponueshme para komisionerit, me shkrim ose, në raste përjashtimore, gojarisht, në mënyrë që të mund të mbahet procesverbal. 2. Organizata me interesa legjitimë paraqet prokurë të posaçme për të përfaqësuar personin ose grupin e personave.*”

Për sa i përket procedurave gjyqësore në nenin 34/1/3 sanksionohet se : “*1. Çdo person ose grup personash që pretendojnë se ndaj tyre është ushtruar diskriminim për një nga shkaqet e përmendura në nenin 1 të këtij ligji, mund të paraqesin kërkesëpadi përparrë gjykatës kompetente sipas përcaktimeve të Kodit të Procedurës Civile për dëmshpërbirim sipas ligjit ose, sipas rastit, të kryejnë kallëzimin përparrë organeve kompetente për ndjekje penale. 3. Një organizatë me interes të ligjshëm ose komisioneri mund të paraqesë padi në emër të një personi ose grapi personash, me kusht që komisioneri ose organizata të ketë pëlqimin me prokurë të posaçme ose me deklarim përparrë gjykatës të personit ose grupit të personave të dëmtuar nga diskriminimi.*”

E drejta për të filluar një procedurë administrative përparrë Komisionerit, apo një procedurë gjyqësore i përket në çdo rast individit që pretendon se është diskriminuar, i cili në bazë të rregullave të përfaqësimit mund t’ia delegojë këtë të drejtë një përfaqësuesi të zgjedhur me vullnetin e tij të lirë. Në mungesë të një akti të tillë përfaqësimi as procedurat para Komisionerit dhe as ato gjyqësore nuk mund të vijojnë. Pra, e dreja e përfaqësimit jo vetëm që nuk merret apriori nga asnje organizatë me interesat legitime në kuptim të këtij ligji, por theksojmë se kjo e drejtë nuk mund t’i kaloj *apriori* asnje personi apo organizate, qoftë kjo edhe organizatë e personave me aftësi të kufizuara, pa patur një pëlqim të shprehur nga ana e personit e aftësi të kufizuara.

Pretendimi i ankuesve për të drejtën ekskluzive të përfaqësimit të personave me aftësi të kufizuara vetëm nga “organizatat e personave me aftësi të kufizuara”, vlerësojmë se mund të kushtëzonte të drejtën e personave me aftësi të kufizuara për të zgjedhur lirisht përfaqësuesin e tyre.

Pretendimi i kërkuesit se pika 9, e nenit 9 të ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010, është në kundërshtim me nenin 46 të Kushtetutës, jo vetëm që është i pabazuar, por në vlerësimin



Adresa: Rruga Sami Frashri, Nr. 10, Kati II, Tiranë
(Tek godina e Fondit Shqiptar të Zhvillimit)
Tel: +355 4 2431078
Fax: +355 4 2431077
e-mail: info@kmd.al
web: www.kmd.al

tonë, nëse pika 9 e nenit 3 të ligjit do të bënte dallime, atëherë mund të ishim përpara një trajtimi diskriminues.

Në nenin 9/2 të Direktivës 2000/78, “**Mbrojtja e të drejtave**” parashikohet se: “*Shtetet anëtare do të sigurojnë që shoqatat, organizatat apo subjektet e tjera ligjore të cilat kanë, në përputhje me kriteret e përcaktuara në legjislacionet e tyre kombëtare, një interes të ligjshëm për të siguruar që dispozitat e kësaj Direktive janë në pajtueshmëri me të, mund të angazhohen, ose në emër ose në mbështetje te ankuesit, me miratimin e tij ose të saj, në çdo procedurë gjyqësore dhe / ose administrative të parashikuar për zbatimin e detyrimeve sipas kësaj Direktive.*”⁵

Nëse i referohemi këtij parashikimi, shohim se përkufizimi i termit “Organizata me interesa legjitime” është në përputhe me sa parashikohet në këtë nen. Në vijim theksojmë se një parashikim i tillë i bërë në nenin 9/2 të Direktivës 2000/78, bëhet edhe në tre Direktivat e tjera të BE-së, në fushën e trajtimit të barabartë.⁶

Edhe pse, pretendimet e ngritura nga ankuesit për përkufizimin e termit “organizata me interesa legjitime”, në kontektin që ai përdoret në ligjin “*Për mbrojtjen nga diskriminimi*”, nuk ka lidhje me aktivitetet advokuese, promovuese apo monitoruese, dëshirojmë të evidentojmë se, **Konventa thekson rolin qëndror dhe përfshirjen në monitorim të personave me aftësi të kufizuara, qoftë individualisht ashtu edhe nëpërmjet organizatave të tyre përfaqësuese, por në asnjë pjesë të saj ajo nuk parashikon se këto procese janë ekskluzive për personat me aftësi të kufizuara apo organizatat e tyre përfaqësuese.** Në nenin 33/3 Konventa parashikon se : “*3. Shoqëria civile dhe veçanërisht personat me aftësi të kufizuara dhe organizatat e tyre përfaqësuese, duhet të përfshihen dhe të marrin pjesë në procesin monitorues*”.

Pika 9 e nenit 3 të ligjit nuk vendos detyrimin për t'u mbrojtur në një proces ligjor nga organizatat e përcaktuara në përkufizimin përkatës dhe as kufizon mundësinë e përfaqësimit direkt. Për më tepër që procedurat e përcaktuara në ligj garantojnë që e drejta për të bërë ankim për diskriminim qoftë përpara Komisionerit, ashtu edhe përpara Gjykatës, të mos merret *apriori* nga asnjë subjekt tjetër. E drejta e ankimit i

⁵ Përkthim jo zyrtar

⁶ Direktiva e Këshillit 2000/43/KE të 29 qershorit 2000; Direktiva e Këshillit 2004/113/KE të 13 dhjetorit 2004; Direktiva e Parlamentit European dhe të Këshillit 2006/54/KE të 5 korrikut 2006.



takon vetëm personit që pretendon se ka pësuar cënim të parimit të barazisë dhe kjo e drejtë mund të delegohet bazuar në shprehjen e lirë të vullnetit.

Për sa i përket dispozitave të Kartës Sociale, të përmendura nga ankuesit, vlerësojmë se ato nuk përbajnë asnjë parashikim i cili mund të shërbejë për të vlerësuar papajtueshmërinë e dispozitave të kundërshtuara, pra ato nuk janë relevante për çështjen në fjalë.

Sa më sipër, shprehemi se pikat 7 dhe 9, të nenit 3 të ligjit nr. 10 221 datë 04.02.2010 “*Për mbrojtjen nga diskriminimi*” nuk vijnë në kundërshtim me Kushtetutën dhe me asnjë prej akteve ndërkombëtare të pretenduara në kërkesat e paraqitura nga Këshilli Kombëtar i Përsonave me Aftësi të Kufizuara dhe Shoqata e të Verbërve të Shqipërisë.



Adresa: Rruga Sami Frashri, Nr. 10, Kati II, Tiranë
(Tek godina e Fondit Shqiptar të Zhvillimit)
Tel: +355 4 2431078
Fax: +355 4 2431077
e-mail: info@kmd.al
web: www.kmd.al